



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-3806 /2021

Klinë, dt. 8/2/2021

Ne mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c), nenit 40.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 botuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenit 40.2 nen piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010 si dhe Rregullores për Subvencione dhe Transfere/2015, Kuvendi i Komunës së Klinës me propozimin e Kryetarit të Komunës ne seancën e vete te rregullt te paren per vitin 2021 të mbajtur më datën 29/01/2021, mori këtë

V E N D I M

Për Ndarjen e Mjeteve Financiare për Fëmijët e Porsalindur

- 1. Miratohet**, ndihma financiare për secilin fëmijë të porsalindur, prindërit e të cilëve janë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës.
Shuma e mjeteve që ndahen për çdo fëmijë të lindur, janë si në vijim:
 - 1.1.** Për fëmijën e parë **180 €** (njëqind e tetëdhjetë euro);
 - 1.2.** Për fëmijën e dyte **200 €** (dyqind euro);
 - 1.3.** Për fëmijën e trete, katërtë e më radhe nga **250 €** (dyqind e pesëdhjetë euro).
- 2.** Mjetet financiare në shumën e cekur si në piken 1 të këtij vendimi, sigurohen nga buxheti i komunës kategoria e subvencioneve dhe transfereve, të cilat sipas kërkesave do të transferohen në xhirrollogarinë e prindërve (nënës, babait apo familjarit përgjegjës kujdestarit) të fëmijëve të porsalindur.
- 3.** Dokumentet e nevojshme për aplikim janë, kërkesa e parashtruar brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga lindja e fëmijës së bashku më dokumentet e bashkangjitura në origjinal, si në vijim:
 - 1.1.** Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
 - 1.2.** Certifikata e vendbanimit e prindit (aplikuesit);
 - 1.3.** Certifikata e bashkësisë familjare e prindit (aplikuesit);
 - 1.4.** Kopja e letërnjoftimit e prindit (aplikuesit);
 - 1.5.** Dokumenti i llogarisë bankare i prindit (aplikuesit);
 - 1.6.** Dëshmia e caktimit të kujdestarit/es, në rastet kur fëmija i porsalindur ka humbur prindërit.
- 4.** Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Kryetari i Komunës në bashkëpunim më Drejtorinë e Administratës dhe Drejtorinë e Financave.
- 5.** Vendimi hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen zyrtare te Komunës së Klinës, i cili do të filloj të zbatohet nga hyrja në fuqi e tij.

Te njoftohen

- MPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoritë përgjegjëse;
- Arkivi.



Kryesuesi i Seancës Kuvendit
Zeqir Morina